



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

**AD-GJTHPZ.nr.2/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit I.B., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit L.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr.837/21, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.26.02.2024 mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e ankuesit I. B., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit L. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal- lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr.837/21.

## **A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës ankuesit I. B., nga Prizreni, ka parashtruar Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit L. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P nr. 837/21.

Ankuesi I. B., nga Prizreni ankesën e ka parashtruar në gjuhën boshnjake ku ka cekur se ka vërejtje në punën e gjyqtarit L. B., tek i cili ka një lëndë penale P.nr.837/2021. Gjyqtari sipas tij po vepron me revanshizëm dhe me torturë ndaj tij dhe bashkëshortes së tij ZejZ.nepe B., pasi që ata edhe me herët kanë parashtruar ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për këtë arsye ai i kanos se do të marrin një dënim të lartë me burgim , kurse me palën tjetër ka një bashkërendim të sjelljeve ku i pranon çdo provë pa përjashtim. Gjithashtu gjyqtari vjen në gjykim në gjendje të alkoolizuar, zakonisht në seanca të mbajtura pas dite dhe është i papërgjegjshëm gjatë këtyre seancave, gabon në diktim të procesverbalit . Ankuesi është thirrur në parimin se secili i akuzuar konsiderohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet e kundërta dhe parimin në gjykimin e paanshëm në afatin e arsyeshëm të cilët parime nuk respektohen nga ana gjyqtarit të lartcekur. Ka kërkuar mbrojtje nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për shkak të parregullsive të lartcekura pasi që

ai dhe e gjithë familja e tij janë të shqetësuar dhe të pasigurte në jetën e tyre të përditshme. Respektivisht ai dhe vëllai i tij janë bashkëpronar në një Objekt ë përbashkët të banimit dhe me të njëjtin kanë probleme të vazhdueshme me të cilin kanë disa lëndë në gjykatë dhe i cili paraqitet si i fuqishëm dhe sipas tij ka lidhje me policinë, prokurorinë dhe me vet gjykatën dhe në mënyrë të padrejtë bën presion ndaj tij dhe familjes së tij. Prandaj bazuar në lartcekura ka kërkuar që gjyqtari L. B., të përjashtohet nga kjo lëndë dhe që ndaj tij të ndërmerren masa disiplinore .

Gjyqtari L. B., në deklaratën e tij lidhur me pretendimet e ankuesit ka cekur me përgjegjësi të plotë morale dhe materiale se asnjë nga të dhënat e cekura në ankesë nuk qëndron. Respektivisht I. B., edhe më herët ka parashtruar ankesë ndaj tij dhe kjo është ankesa e dytë nga të njëjtit për çështje të njëjtë. Në lëndën penale P.nr.837/21 në shqyrtimin kryesor pas parashtrimit të kërkesës për hedhje të aktakuzës gjyqtari e refuzuar këtë kërkesë ku avokati i të akuzuarit të dytë Alija Ajro ka parashtruar ankesë dhe Gjykata e Apelit e ka refuzuar Ankesën si të pabazuar. Pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi gjykata ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor i cili është mbajtur në disa seanca duke respektuar Kodin e procedurës Penale sa i përket rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor duke u përmbajtur parimeve të këtij kodi. Kjo mund të vërtetohet në bazë të procesverbaleve të këtyre shqyrtimeve ku janë shkruar në mënyrë strikte çdo fialë e thënë nga secila palë në prezencë të përkatshes së gjykatës dhe palëve të tjerë në procedurë. Në procesverbale të bashkangjitura nga ana e gjyqtarit i njëjti ka cekur se I. B., gjatë shqyrtimit me sjellje të tij ndaj palës kundërshtare ka vepruar kundër dispozitave ligjore dhe nenit 297 të KPP dhe gjyqtari gjykues i ka tërhequr vërejtjen gojariht për sjelljen e tij. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur dhe prezent kanë qenë të gjithë palët tjerë të cilët nuk kanë pasur vërejtje në punën e gjyqtarit . Veprimet e të akuzuarit gjatë shqyrtimit të dt. 17.01.2024 kanë për qëllim zvarritjen e kësaj çështje dhe në këtë drejtim i akuzuari edhe ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit nga kjo çështje. Pas kësaj gjyqtari ka ndërprerë seancën dhe lëndën ia ka dorëzuar Kryetares së Gjykatës në vendosje lidhur me përjashtimin. Të akuzuarit kanë refuzuar të nënshkruajnë këtë procesverbal. Sipas gjyqtarit nuk qëndrojnë asnjë nga pretendimet të ankuesit .

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar Ankesë ndaj gjyqtarit L. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal, lidhur me lëndën P.nr.837/21 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës P.nr.837/21 Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

NE Gjykatën Themelore ne Prizren nga ana e Prokurorisë Themelore ne Prizren është dorëzuar aktakuza me dl. 03.08.2021 ndaj te akuzuarve I. B., për shkak te veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par. I nënpar. 1.4 te KP , Enver B., për shkak te veprës penale sulmi nga neni 184 par.3 lidhur me par 1 nenpar.3.1 të KP dhe Z B., për shkak te veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. I të KÏ). Lënda sipas evidencës në SMIL në mënyrë automatike i është ndarë gjyqtarit L. B., Shqyrtimi fillestar është mbajtur me dt. 12.10.2021 , prezent kane qenë Prokuroi i shtetit, te akuzuarit si dhe mbrojtësi i të akuzuarit I. B., av. N.M., dhe mbrojtësi të akuzuarit E B., av. A.A., si dhe perkthyesi i gjykatës për gjuhën boshnjake . IME tej janë mbajtur edhe shqyrtime tjera të parapara me KPP si dhe në shqyrtimin gjyqësor me dt. 17.012024 gjatë dëgjimit të një dëshmitari kane reaguuar i akuzuari I. B., dhe avokati i tij N.M., në lidhje me procedurën e provave ku gjyqtari i ka tërhequr vërejtjen për respektim të rendit në

gjykatë . Nga kjo situatë avokati N.M., ka kërkuar që të ndërpritet seanca dhe se kërkon përjashtimin e gjyqtarit nga kjo lëndë për shkak se gjyqtari po zhvillon seancën në mënyrë të tensionuar. Me leximin e procesverbaleve të mbajtura si Autoriteti Kompetent nuk kam vërejtur se gjyqtari ka vepruar njëanshëm gjatë zhvillimit të procedurës cihe mbajtjes së shqyrtimeve , por duke pasur parasysh se pala I. B., ka parashtruar kërkesë për përjashtim të gjyqtarit nga kjo lëndë dhe duke pasur parasysh se ka parashtruar edhe kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj të njëjtit në KGJK konsideroj se pala ka humbur besimin tek gjyqtari i rastit andaj edhe kam përjashtuar të njëjtin nga kjo lëndë me Aktvendim IV.AGJ.nr. 1/24-9 me dt. 14.01.2024. Sa i përket vërejtjeve dine ankesave tjera të cilat janë parashtruar nga pala I. B., nuk ka prova të cilat do të vërtetonin të njëjtat , asnjëra palë në procedurë nuk ka shprehur shqetësime në lidhje me gjendjen e gjyqtarit gjatë shqyrtimit cihe veprimet të cilat do të inkriminonin cihe do të rezultonin me shkelje disiplinore .

Andaj si Autoritet Kompetent bazuar në të lartëcekura konsideroj se gjyqtari L. B., në veprimet e tija nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 par. 1 nënpar.1.3 cihe nenin 5 par.2 nënpar.2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dine Prokurorëve ku është paraparë trajtim i ligj i palëve në procedurë gjatë ushtrimit të detyrës së tij zyrtar si gjyqtar.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**AD-GJTHPZ.nr.2/2024, me dt.26.02.2024**

**Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren**

**Shpresa Emra**

  
Shpresa Emra  
aparë e drejta e ankesës.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, nuk është e paraparë e drejta e ankesës.